



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2014

RELACION

Lënda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të KMDP-së për vitin 2013

Drejtuar: Znj. Geraldina Prodani

Sekretare e Përgjithshme

TIRANE

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në zbatimin e buxhetit të vitit 2013, është mbështetur në kërkesat me të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhenave personale”.

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në lidhje me performancën financiare buxhetore, për tremujorin e parë, ka vepruar me korrektesë në zbatim të Ligjit nr, 119/2012 datë 17/12/2012”Për buxhetin e vitit 2013”, Udhëzimit nr.2, datë 6/02/2012”Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit’, Udhëzimit plotësues nr.1/1, datë 19.02.2013’Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013”

Në mbështetje të Ligjit nr. 119/2012 17/12/2012”Për buxhetin e vitit 2013”, për vitin 2013, është miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhenave Personale 1 program buxhetor :

- Programin me emërtimin « Planifikim, menaxhim dhe administrim » ku përfshihet i gjithë buxheti i akorduar për funksionimin e aktivitetit të Zyres së Komisionerit për mbrojtjen e të Dhenave Personale

Në zbatim të udhëzimit nr.1/1 datë 19.02.2013’Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013” po ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për vitin 2013, sipas modeleve standarde të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

KMDP i është akorduar një fond i planifikuar prej **42211 ne mijë leke** , me ndryshimet **perkatëse te cilat** përbëhen nga:

Fondi i Pagave:	28.500 mijë leke (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	4.500 mijë leke (zeri 601)
Fondi për Shpenzime Operative	7638 mijë leke (zeri 602)
Fondi për Investime:	1.000 mijë leke (zeri 231+230)
Transferime korrente	486 mijë leke (zeri 606)
Kuotizacione	87 mijë leke (zeri 605)

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave Personale , ka realizuar vlerën buxhetore në **vitin** 2013.sa me poshtë vijon

1- Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore,(zeri 600-601), është realizuar ,në zbatim të strukturës organizative të miratuar, Nr. 225 dtatë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës , organikes dhe katekorizimit të pagave të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale numri mesatar i punonjesve është realizuar 28 vetë, nga 29 vetë të miratuar.

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit, për paga dhe sigurime shoqërore, ishte 33.000 në mijë lekë. Ky fond përputhej me kërkesën e mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e institucionit , sipas strukturave organike të tyre.

Si rezultat i mosplotësimit në kohë të strukturës,largimit të punonjesve me dorëheqje por dhe me masa disiplinore si dhe dështimi i procedurave të konkurrimit gjatë vitit realizimi është në masën 91 % si për paga ashtu dhe sigurime shoqërore , gjë që influencën në realizimin e përgjithshëm të buxhetit të akorduar.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht 1 26056 (në mijë leke) për paga si dhe , 4032 në mijë lekë për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose 92 % e fondit të planifikuar vjetor

2- Fondi për shpenzim investime (zeri 231) , nga vlera e përgjithshme prej 1,000 (në mijë leke) për periudhën e raportuar, është prokuruar dhe realizuar në masën 983.422 leke në mijë leke ose 98 % e fondit të planifikuar vjetor.

Gjatë vitit 2013 , një nga detyrat parësore dhe prioritare ka qenë ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, udhëzimit nr.2, datë 28/03/2013, i ndryshuar ”Për procedurën e blerjeve të vogla” në mënyrë elektronikë , mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara për investime e konkretisht janë realizuar investimet e mëposhtme.

- ✓ Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “**Blerje orendi zyre** ”, për plotësimin e kushteve optimale të pershtatshme të punës së punonjesve , mobilieri të sallës së arkivës , me raftë komode për ruajtjen edhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore si dhe të plotësimit të kërkesave të nepunësve me orendsi (karrige komode) , pajisjeme kondicioner të një zyre me sipërfaqe relativisht të madhe. Janë planifikuar 457 në mijë leke me TVSH dhe janë realizuar nga ky fond shuma prej **447** në mijë leke ose rreth 98 % e fondit të planifikuar pranë personit fizik Arber Gjanaj .

- ✓ Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “**Blerja pajisje kompjuterike**” është realizuar me procedurën blerjeve të vogla -blerje të aktiveve me të domosdoshme për punonjësit. Fondi i alokuar nga Ministria e Financave në Projektin M890010(480 në mijë leke është realizuar me procedurën blerje të vogël, pranë Firmës BNT Elektronics në shumën **474 (në mijë leke)** . ose rreth 99 % e fondit të planifikuar. Diferencat janë për shkak të procedurave të prokurimit.
- ✓ Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Zhdoganimi i mjetit” M890009 i cili mundësoi kalimin në pronësi të mjetit TIP Benz, të marrë nga Drejtoria e Rezervave të Shtetit me procedurën e kalimit Kapital Fondi i alokuar nga Ministria e Financave në Projektin M890009(63 në mijë leke) është realizuar në shumën 62 (në mijë leke) pra rreth 98 % e fondit të planifikuar.

3- Fondi për shpenzim Operative (zëri 602) , nga vlera e përgjithshme prej 7638 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar, është prokuruar dhe realizuar në masën 7637.6 në mijë leke ose 100 % e fondit të planifikuar vjetor. duke respektuar kërkesat e detajuara në Regjistrin e Prokurimeve Publike, të deklaruar në Agjensinë e Prokurimit Publike.

Në pasqyrën sipas **Formatit Nr 6** është paraqitur plani vjetor si dhe realizimi vjetor në nivel programi, e ndarë sipas zerave kryesore të buxhetit.

Regjistri i prokurimeve , me ndryshimet, është realizuar në përmbushje të objektivave dhe strategjisë së miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhenave personale për vitin 2013. e ndarë në produktet të cilat u me mbështetjen financiare të fondeve të alokuara nga Ministria e Financave e konkretisht

Gjate vitit 2013 në lidhje me performancën financiare kemi evidentuar nevojat më emergjente si dhe janë rishikuar objektivat dhe aktivitetet e drejtorive ,në zbatim të Aktit Normativ nr.6,datë 4/10/2013 e cila kondicionoi rishpërndarjen e fondeve në zëra buxhetore,sipas kërkesave të drejtorive. .

Në zbatim të legjislativave në fuqi, në fushën financiare e konkretisht në zbatim të Ligjit nr.9477,të datës 09/02/2006“Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” është kryer evidentimi dhe hedhja në sistemin e programit financiar çdo transaksioni në mënyrë kronologjike gjë që krijon mundësinë e një analize të plotë financiare për çdo zë shpenzimi në raport me shpenzimet e përgjithshme,jep një pasqyrim sa më të saktë të çdo tejkalimi apo efektiviteti dhe mundësi për rialokime në zëra të tjera të domosdoshme ,në përmbushje të realizimit të detyrave dhe objektivave ,të parashikuara në strategji.

Janë menaxhuar me kujdes dhe likuiduar çdo detyrim për shërbimet e përgjithshme sic janë ato të elektricitetit, ujit, telefonisë fikse e celulare,

Janë marrë të gjitha masat për të menaxhuar me kujdes dhe me ekonomi fondet publike, në drejtim të plotësimit të kërkesave për zhvillimin e aktiviteteve që kryen në kuadër të plotësimit dhe zbatimit të strategjisë së miratuar (seminare ndergjegjësusese në rreth të ndryshme të vendit, si dhe kryerjen e

inspektimeve administrative brenda e jashtë rrethit, si dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. .

Janë marrë masat për përfaqësimin e institucionit tonë në Konferencën e eventndërkombëtare e rajonale, me burime njerëzore e financiare, të përdorura me efikasitet dhe me ekonomi.

Në zbatim të legjislativës në fushën financiare, janë ndjekur procedurat për inventarizimin e asetëve afatgjatë e afatshkurtra, nëpërmjet komisioneve të ngritura, të cilat kanë ndjekur udhëzimet dhe procedurat miratuara nga titullar, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për menaxhimin e aktiveve.

4- Fondi për shpenzime të tjera (kuotizime + transferime në buxhete familjare) 605-606, për vitin 2012, është planifikuar në vlerën 450 në mijë leke leke, me ndryshimet e rialokimeve si dhe ndryshimet e rishikimit të buxhetit ky fond është në masën 545 në mijë lekë. Për periudhën 12 mujore, në total është realizuar në masën 543.315 ose 99.5 % e fondit të planifikuar dhe likuaduar sipas destinacionit të përdorimit.

Formati nr 7-Aneksi 9

Realizimi dhe monitorimi i përdorimit të fondeve publike në nivel të përgjithshëm programi dhe realizimi ka qenë në masën 93 %. kundrejt vjetorit

Formati nr 8

Në këtë format është paraqitur realizimi i produkteve (në sasi) nga kryerja e aktivitetëve në zbatim të objektivave dhe strategjisë së miratuar për vitin 2013.

Konkretisht :

Përsa i përket **produktit F Shërbime të përgjithshme dhe infrastrukture**, realizimi është shprehur në vlerë dhe numër. Në vlerë në këtë produkt janë përfshirë sigurimi i shërbimeve të përgjithshme për të gjithë personelin, si furnizimi me ujë, dritë, telefon, shërbime sigurimi, shërbime abonimi për të gjithë stafin si dhe furnizimi me mallra e shërbime të mbarevajtjes së punës së përditshme, kanceleri, shërbime transporti si dhe pagat e punonjësve të shërbimeve mbështetëse. Gjithashtu pjesë e saj është dhe ofrimi dhe krijimi i kushteve sa më të mira pune, nëpërmjet pajisjes së çdo punonjësi me asetet e nevojshme (orëndi, informatike etj)

Produkti A Shërbime ligjore, njësia matëse e së cilës është nr. (janë përfshirë udhëzime të miratuara, raporte periodike në institucione monitoruese, marrëveshje të lidhura etj. Sqarohet se për vitin 2013 janë dhënë mendime për akte ligjore e nënligjore

Gjithsej 30 mendime dhe opinione dhe asistencë nga fusha e legjislativës të ndryshme.

Janë hartuar dhe miratuar 7 udhëzime si dhe një vendim

Janë miratuar 8 dokumente te rendesishem (ku perfshihen dhe hartime mauale,udhëzues për kontrooluesit në fusha tëndryshme,rregullore etj) dhe njëkohësisht është miratuar Strategjia institucionale 2014-2017.

Janë pergatitutr 3 raporte (tremujore) në kuader te PKZMSA (2012-2015) ,percjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë

Jane trajtuar 5 kërkesa për dhënie të Autorizimit të transferimit Ndërkombëtar të të dhenave Personale si dhe eshte dhene 1 vendim

Janë lidhur 2 mareveshje bashkepunimi si dhe jane pergatitur rreth 3 projekt mareveshje bashkepunimi .

Produkti B lidhur me ndërgjegjësimin dhe rritjen e shkallës së tij si për të rinjtë (duke perfshirë kategorite e shkollave 9 vjecare ,të mesme të larta) kuptim te ligjit – quhen subjekte të të dhënave personale . jane zhvilluar 6 aktivitete me te rinjte.

Eshte hartuar,miratuar revista nr. 1dhe 2 “ligj dhe Privatesi “ ,per te cilen per te cilat ka perfundura vetem priontimi i nunrit te pare nepermjet procedurave t e tenderimit (blerje e vogel) online.

Eshte publikuar dhe nje flete palosje ne lidhje me perdorimin e celulareve smartfone dhe teknplogjise se informacionit .

Produkti B1 – Kontrollues të ndërgjegjesuar në plotesim të objektivit për rritjen e ndërgjegjësimit të kontrolluesve publike e privatë .

Ky produkt realizohet nëpërmjet **seminarëve ndërgjegjësues** i cili mund të jetë në vetevete një matës apo indikator mbi performancën e Drejtorisë së Marëdhënieve me Publikun.

Gjithsej jane organizuar 15 semiare dhe aktivitete ku kane marre pjese rreth 850 pjesemarres.

Produkti D “Subjekte te regjistruar” njësia matese e së cilës eshte numër të regjistruarish subjektsh private e publike, është pjesë e një veprimtarie të gjere identifikimi,plotësimi informacioni para deklarimit zyrtar,vlerësime ligjore të perpunimit të të dhënave personale

Numri i të regjistruarve për vitin 2013 është 560 .

Numri i njoftimeve per te ardhur fizikisht por dhe online eshte 609 subjekte . jane derguar rreth 2011 shkresa sensibilizuese drejt subjekteve kontrolluese(773 e-maile) .

Numri i eprgjitshem e njoftimeve duke filluar nga viti 2009-2013 eshte 4552 ,ndersa numri i pergjitshem i subjekteve te regjistruar eshte 3927.

Produkti E Inspektime dhe trajtim ankesash, njësia matëse e të cilit është numër, është pjesë e një veprimtarie të gjere e cila përfshin kontrole tematike të planifikuara, publik apo privatë ,si dhe hetim e trajtime mbi bazë ankesash të ardhura në forma të ndryshme ,monitorime e ndjekje rekomandimesh të vendosura nga Zyra e KMDP,monitorime të regjistrit të njoftimeve dhe ne rast

mos deklarimi të këtij detyrimi ligjor, indicje për vendosje të masave administrative me gjobë, e në përfundim ndjekja e procedurave për ekzekutim të tyre

Jane trajtuar gjithsej për vitin 2013 26 ankesa .

Janë kryer kontrole administrative për vitin 2013 ,213 kontrole dhe inspektime administrative (mbi baze plani, monitorimi dhe ankesash) .

Inspektimet janë realizuar brenda dhe jashtë Tiranës.

Në kuadër të realizimit të objektivave ka vijuar puna për ndjekjen dhe dënimin e rekomandimeve të cilat janë rreth 55 të tilla

Janë dhënë 7 masa administrative me gjobë

Jane hartuar 26 urdhera për zbatim

Formati nr 9

Në këtë format është paraqitur realizimi i produkteve (në vlerë) nga kryerja e aktiviteteve në zbatim të objektivve dhe strategjisë së miratuar për vitin 2013

Për çdo produkt është përfshirë kosto e shpenzimeve për paga, sigurime, si dhe shpenzimet operative direkte të pjesëmarrjes.

Sqarohet se në produktin **G-Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare** –është identifikuar si produkt me vete ,si në sasi dhe në vlerë , për të identifikuar më vete shpenzimet e shërbimeve të përgjithshme administrative që ofron D.SH.M për të gjithë stafin nga pjesa tjetër: Menaxhim i Lartë ku pjesë e shpenzimeve janë paga, sigurime të kabinetit dhe shpenzimet e zërit **602-Mallra e shërbime –Dieta me jashtë** –pjesa më e madhe e së cilës shkon për të mbuluar koston e pjesëmarrjes në këto evente të rëndësishme për ecurinë, aderimin dhe afirmimin e institucionit në rang ndërkombëtar.

Aktualisht për vitin 2013 ka patur 5 përfaqësime në evente rajonale e ndërkombëtare

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave Personale , ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji për mbrojtjen e të Dhenave personale si dhe legjislacionin administrativ-financiar shqiptar.

Drejtoresha e Shërbimeve Mbështetëse

Lindita Morina

